# REPUBLIKA E KOSOVËS

## KOMUNA VUSHTRRI

**Zyra e Informimit**

**Komunikatë për medie**

## U përurua rruga e asfaltuar dhe ura në fshatin Druar

**Vushtrri, 09 07 2010**

Në fshatin Druar të Vushtrrisë është bërë përurimi i rrugës së asfaltuar dhe urës. Në përurimin e këtij projekti të rëndësishëm në përmirësimin e jetesës së banorëve të asaj ane e kanë bërë ministri i ekonomisë dhe financave Ahmet Shala bashkë me kryetarin e komunës Bajram Mulaku. Ministri Shala tha se qeveria e Kosovës në bashkëpunim edhe me komunat do të investoj në përmirësimin e infrastrukturës në gjithë Kosovën. "Qeveria e Kosovës në bashkëpunim edhe me kryetarin e komunës do të bëjnë gjithçka është e mundur që që këtë pjesë të mos kursej në infrastrukturë", tha ministri Shala.

Investimet në këtë projekt kryetari i komunës Bajram Mulaku i vlerësoi shumë të rëndësishme në krijimin e kushteve të jetesës për banorët e Druarit. "Kjo rrugë ka krijuar kushte të reja shumë më të mira për jetesë në këto anë se që kanë qenë më herët. Jo vetëm këtu por edhe në vendbanime tjera po realizohen projekte të tilla", tha Mulaku.

Asfaltimi i kësaj rruge në gjatësi prej 2230 metra ka kushtuar 269 524 Euro. Nga buxheti komunal janë investuar 259 534 Euro, derisa nga komuna 10 mijë Eurove janë donacion ministria e administrimit të pushtetit lokal.

**Kontakt:**
**Zyra e Informimit**
**Tel: 028 571 524**
**e-mail: komuna.vushtrri@ks-gov.net**
**web: kk.rks-gov.net/vushtrri**